



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 223 Akti

Nr. 192 Vendimi
Tiranë, më 31.7.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli
Etleda Çiftja
Roland Ilia

Kryesuese
Anëtare
Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 30.7.2019, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Altin Dumani, me detyrë prokuror, aktualisht drejtues i Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Altin Dumani, vëzhguesin

ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Altin Dumani, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Altin Dumani, prokuror/drejtues i Prokurorisë së Apelit për Krimet e Rënda është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.11.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Altin Dumani, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Firdes Shuli dhe Etleda Çiftja. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 26.11.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues, komisionere Firdes Shuli, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Altin Dumani.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Altin Dumani, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me subjektin.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 18.4.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Altin Dumani.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2019 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 18.7.2019), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Altin Dumani.*

10. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit me nr. *** prot., datë 12.3.2019.

11. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës, në datën 19.7.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Altin Dumani; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit, në datën 19.7.2019, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 22.7.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 25.7.2019.

14. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet e tij në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, në datën 26.7.2019, vendosi të ftojë z. Altin Dumani në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 26.7.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Altin Dumani, u zhvillua në datën 30.7.2019, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Subjekti i rivlerësimit, z. Altin Dumani, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Altin Dumani, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Altin Dumani ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur ato janë kërkuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjektit në ILDKPKI; (ç) provat shkresore/dokumente të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Altin Dumani, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumente të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Altin Dumani, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, të vitit 2017, me nr. indeksi ***, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2003 – 2017, në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

- ❖ Pasuri e paluajtshme, **apartament**, me sip. 127.4 m², me vendndodhje: pallat 5-katësh pranë ***, blerë me kontratë porosie datë 18.8.2006, lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k. Vlera totale është 50,000 euro. Zotërimi: 100 % së bashku me bashkëshorten.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- shuma 9,000 euro nga kursimet në momentin e nënshkrimit të kontratës;
- kredi në shumën 5,000,000 lekë, marrë në datën 1.11.2006, në “Raiffeisen Bank”.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë, pasi apartamenti nuk është i regjistruar.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni rezultoi se me kontratën e porosisë nr. ***, datë 18.8.2006, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë lidhur kontratë porosie me shoqërinë “****” sh.p.k.

Objekti i kontratës është ndërtimi për porositësin (subjektin e rivlerësimit) i një apartamenti me sip. 127.12 m², pranë ***, Tiranë. Vlera e kontratës së porosisë është 50,000 euro. Kalimi i pronësisë do bëhet nëpërmjet kontratës përfundimtare të shitjes. Çmimi i shitjes së apartamentit do likuidohet:

- kësti i parë në shumën 9,000 euro, paguar ditën e nënshkrimit të kontratës nga kursimet;
- kësti i fundit në shumën 41,000 euro do të paguhet me marrjen e një kredie nga “Raiffeisen Bank”.

Shoqëria “****” sh.p.k., për të vërtetuar realizimin e kontratës me subjektin e rivlerësimit ka lëshuar vërtetim në datën 19.1.2016, administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ku deklarohet se subjekti i rivlerësimit ka shlyer detyrimin si më poshtë:

- kësti i parë në shumën 9,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës;
- kësti i dytë në shumën 2,950,000 lekë në datën 16.11.2006;
- kësti i tretë në shumën 2,400,000 lekë në datën 16.1.2008 (transfertë bankare).

Në deklaratën vjetore periodike për vitin 2006, të dorëzuar në ILDKPKI, rezultoi se për këtë pasuri subjekti ka deklaruar:

*Kontratë porosie për blerje apartament banimi me sip. 127.14 m², më datë 18.8.2006, në një godinë pallat 5-katësh pranë ***, Tiranë. Vlera totale e apartamentit është 50,000 euro.*

- *Shuma e shlyer është 9,000 euro në momentin e lidhjes së kontratës dhe 2,950,000 lekë në datën 16.11.2006 në momentin e marrjes së kredisë.*
- *Detyrimi i mbetur është 2,000,000 lekë, i cili do të bëhet pas plotësimit të dokumentacionit të pronës dhe do të paguhet nga pjesa e mbetur e kredisë.*

Lidhur me burimin e shumës 9,000 euro, si këst i parë i paguar, subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni, i cili ka deklaruar¹:

“Burimi i shumës 9,000 euro të paguara në momentin e nënshkrimit të kontratës, siç kam shpjeguar dhe në deklaratën e rivlerësimit janë nga kursimet në vite. Kjo shumë është paguar nga gjendja cash e disponuar në banesë. Gjendja e llogarive bankare në këtë vit nuk është pakësuar”.

Në deklaratën periodike për vitin 2003, të dorëzuar në ILDKPKI, rezultoi se subjekti ka deklaruar gjendje cash në shumën 500,000 lekë. Në deklaratën periodike për vitin 2005, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat në vlerën 1,100,000 lekë, ndërsa në deklaratën periodike për vitin 2006 subjekti ka deklaruar kursime nga paga në vlerën 1,200,000 lekë.

Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar saktë burimin e financimit të shumës 9,000 euro, si në deklaratën “Vetting”, edhe në deklaratat periodike vjetore dhe se ai ka pasur mundësi dhe burime financiare të ligjshme për shlyerjen e këstit të parë për blerjen e kësaj pasurie.

Lidhur me burimin e shumës së mbetur 41,000 euro, rezultoi se subjekti ka përfituar kredi në “Raiffeisen Bank”, në shumën 5,000,000 lekë, marrë në datën 1.11.2006². Likuidimi i kësaj shume ndaj palës shitëse është bërë më dy këste, përkatësisht në vitin 2006 dhe në vitin 2008.

Në lidhje me shoqërinë “***” sh.p.k., është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili ka deklaruar³:
*“Bashkëshortja ime A.D., (P., mbiemri i vajzërisë) ka lidhje gjinore me administratorin e shoqërisë “***” sh.p.k., z. A.P., të cilin e ka djalë xhaxhai. Unë kam një periudhë 20-vjecare që punoj në Prokurori nuk rezulton që të kem qenë i përfshirë në ndonjë hetim ku administratori/administratorët apo pronari/pronarët e shoqërisë të jenë përfshirë”.*

Komisioni konstatoi se likuidimi i këtyre dy kësteve të fundit është bërë nëpërmjet llogarisë bankare dhe burim ka qenë kredia e përfituar nga subjekti. Shlyerja e këtyre kësteve është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006 të depozituar në ILDKPKI, dhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, ku është deklaruar shlyerja e detyrimit të fundit të mbetur në vlerën prej 2,400,000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie dhe kryerjen e disa punimeve shtesë për këtë pasuri.

Gjithashtu, lidhur me këtë pasuri, pagimin e këstit të fundit, si dhe shpenzimet e kryera, subjekti është pyetur sipas pyetësorit nr. 2, i cili ka deklaruar⁴:

¹ Shikoni përgjigjet e subjektit të datës 19.6.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

² Shikoni dosjen e dërguar nga “Raiffeisen Bank”, administruar në dosjen e ILDKPKI-së dhe të Komisionit.

³ Shikoni përgjigjet e datës 8.7.2019, të subjektit, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴ Shikoni përgjigjet e subjektit të datës 19.6.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

*“Dua të sqaroj se në apartamentin tek *** kemi filluar të banojmë që prej tetorit të vitit 2004. Shpenzimet e arredimit dhe punime të brendshme për këtë pasuri në total kapin shumën 1,400,000 lekë”.*

Komisioni konstatoi se çmimi i blerjes së kësaj pasurie është në vlerën rreth 390 euro/m². Komisioni vlerësoi këtë çmim në raport me çmimet e tregut, kontratat e ngjashme të porosisë, apo shitblerjes në këtë zonë, dhe ky çmim nuk rezultoi nën koston e ndërtimit të zonës në fjalë. Bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, rezulton se kostoja e ndërtimit për qytetin e Tiranës për vitin 2006 është 28,860 lekë/m².

Në përfundim konstatohet se:

Rezulton se shlyerja e plotë e shumës për blerjen e kësaj pasurie është bërë në janar të vitit 2008. Bazuar në provat e administruara dhe në analizën financiare Komisioni konstatoi mundësinë financiare të subjektit për shlyerjen e detyrimeve për blerjen e kësaj pasurie nga burime të ligjshme.

❖ **Ambient**, me sip. 28 m², me adresë: Pallati i Ri pranë “***”, Tiranë, blerë me kontratë porosie me shoqërinë “***” sh.p.k., datë 26.5.2009. Vlera: 28,000 euro. Pjesa takuese: 100 % me bashkëshorten.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- kursime nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes (pakësim i depozitave, gjendjes *cash* dhe llogarive rrjedhëse në banka);
- vlera totale është 28.000 euro, ku shuma 20.000 euro është paguar në momentin e lidhjes së kontratës, dhe pjesa tjetër 8.000 euro është paguar në vitin 2011.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë dhe Bashkisë Tiranë; apartamenti nuk është i regjistruar.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Gjatë hetimit u konstatua se kontrata e porosisë nr. ***, datë 26.5.2009, është lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes me shoqërinë “***” sh.p.k. Objekti i kontratës është porositja nga subjekti i rivlerësimit i një ambienti zyrë me sip. 28 m². Vlera e kontratës është 28,000 euro.

Mënyra e shlyerjes së pagesës do jetë:

- kësti i parë në shumën 20,000 euro, me nënshkrimin e kësaj kontrate;
- kësti i dytë dhe i fundit në shumën 8,000 euro, në momentin e dorëzimit dhe lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes.

ZVRPP-ja Tiranë nuk konfirmoi regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrin e pasurive të paluajtshme, kurse Bashkia Tiranë konfirmon se kjo pasuri është e regjistruar në programin informatik si pronë me status aktiv, nga data 1.1.2016. Gjatë fazës hetimore nuk rezultoi të jetë lidhur kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie të paluajtshme, megjithëse likuidimi i vlerës së kontratës së porosisë është kryer plotësisht nga subjekti i rivlerësimit.

Është pyetur subjekti dhe në përgjigje të pyetësorit ka deklaruar se për këtë pasuri ka paguar taksat vendore duke paraqitur si provë edhe vërtetimin nr. *** prot., datë 3.7.2019, të Njësisë Administrative Farkë, ku theksohet se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton në listën e debitorëve të kësaj njësie administrative.

Në deklaratën periodike për vitin 2009, lidhur me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar:

*Ambient zyrë me sipërfaqe 28 m² pranë kopshtit zoologjik, me kontratë porosie, datë 26.5.2009, e lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k. Vlera totale është 28.000 euro. Burimi i krijimit: kursime në vite nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes (pakësuar gjendja cash në vite). Pjesa takuese: 50 %. Detyrimi ndaj firmës “***” sh.p.k. për blerjen e zyrës në shumën 8,000 euro.*

Komisioni konstatoi se për këtë pasuri, në deklaratën periodike për vitin 2011, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar shlyerjen e detyrimit të fundit në shumën 8,000 euro ndaj shoqërisë “***” sh.p.k., për blerjen e kësaj pasurie.

Lidhur me këtë pasuri, vlerën e blerjes, përdorimin e gjendjes *cash* dhe pagimin e detyrimeve për këtë pasuri, Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit, i cili deklaroi⁵:

“Në lidhje me pyetjen nr. 2 kam për të thënë se në vitin 2009, për blerjen e ambientit me sipërfaqe 28 m² janë paguar vetëm 20,000 euro. Rreth 1,000,000 (një milion) lekë janë marrë nga depozita dhe llogaria rrjedhëse në emër të bashkëshortes A.D., në Intesa Sanpaolo Bank, ndërsa shuma rreth 1,650,000 (një milion e gjashtëqind mijë) janë paguar nga pakësimi e gjendjes cash, akumuluar në vite. Ndërsa shuma prej 8,000 euro është shlyer në 30 dhjetor 2011 me anë të një transferte në shumën prej 5,685 euro (ish-depozitë në Tirana Bank) dhe shumës prej 1,480 euro tërhequr nga llogaria rrjedhëse në Tirana Bank, po atë ditë. Pjesa e mbetur prej 835 euro (110,000 lekë) është paguar cash”.

Bazuar në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen *cash* dhe kursimet ndër vite deri në vitin 2009, periudhë që është blerë kjo pasuri. Bazuar në deklaratimet e subjektit dhe llogaritjet e kryera nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për përballimin e shumës prej 1,650,000 lekësh nga kursimet dhe gjendja *cash*. Lidhur me burimin e financimit nga llogaria bankare, rezultoi se subjekti ka tërhequr depozitat nga “Intesa Sanpaolo Bank” në datat 2.4.2009 dhe 21.4.2009, në vlerën prej 1,070,200 lekësh, shumë e cila ka kaluar më pas te shoqëria shitëse. Edhe deklaratimet e tjera për përballimin e pjesës së mbetur prej 8,000 euro në vitin 2011 për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, pas verifikimeve të kryera nga Komisioni, rezultuan të sakta. Të gjitha veprimet e kryera nga subjekti për blerjen e kësaj pasurie janë deklaruar saktë edhe në deklaratat periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI.

Gjithashtu, subjekti është pyetur për lidhjen e kontratës së qirasë për lëshimin nga ana e tij me qira të këtij ambienti, vlerat e përfituara, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore që lindin për këtë pasuri.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të datës 19.6.2019⁶, subjekti ka deklaruar:

*“Kjo kontratë është lidhur verbalisht mes dy palëve, pa u konkretizuar me një kontratë me shkrim. Sipas nenit 803 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, kontrata e qirasë për një kohë më të gjatë se një vit duhet bërë me shkresë. Siç del edhe nga deklaratat noteriale mes meje dhe shtetas B.K., kjo marrëdhënie qiraje ka zgjatur vetëm një vit. Deklarata noteriale e datës 31 dhjetor 2012 konfirmon pikërisht këtë marrëdhënie, si dhe kushtet e saj. Lidhur me pagesën e tatimit në burim, ju vë në dispozicion vërtetimin nr. ***, datë 14.6.2019, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me anë të të cilit provohet pagesa e tatimit në burim lidhur me këtë shumë të përfituar nga qiraja”.*

Komisioni, bazuar në shkresën e Bashkisë Tiranë (vërtetimi nr. *** prot., datë 13.6.2009, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë), konstatoi

⁵ Shikoni përgjigjet e subjektit të datës 19.6.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶ Shikoni përgjigjen e subjektit të datës 19.6.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

kryerjen e pagesave lidhur me detyrimet vendore të subjektit ndaj kësaj bashkie për këtë pasuri të paluajtshme.

Në përfundim konstatohet se:

Për këtë pasuri është shlyer e gjithë vlera e detyrimit për blerjen e kësaj pasurie, megjithëse nuk është lidhur akoma kontrata përfundimtare e shitjes. Veprimet e subjektit për blerjen e kësaj pasurie janë deklaruar saktë si në deklaratat periodike vjetore, edhe në deklaratën “Vetting”. Rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar saktë vetëm ndryshimin e gjendjes *cash* në deklaratën periodike për vitin 2009.

Bazuar në provat e administruara, deklaratat periodike vjetore për deklarimin e pasurisë dhe në analizën financiare të hartuar, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi financiare dhe burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

❖ **Apartament**, me sip. banimi 75.7 m² dhe sip. e përbashkët 10 m², në ***, Tiranë; blerë me kontratë shitblerjeje, datë 1.4.2015, me shoqërinë “****” sh.p.k. Vlera është 41,000 euro, e cila është likuiduar e plotë nëpërmjet “Bankës Kombëtare Tregtare”, në datën 2.4.2015. Pjesa takuese: 100% i kësaj pasurie së bashku me bashkëshorten.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

▪ kursime në vite nga gjendja e depozitave, gjendjes *cash* dhe llogarive rrjedhëse në banka.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet nga ZVRPP-ja dhe DPPPP-ja Tiranë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Rezultoi se në datën 1.4.2015 subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë shitblerjeje me nr. ***, për blerje pasurie apartament, me sip.75.7 m², e ndodhur në ***, Tiranë. Kalimi i pronësisë nga shoqëria shitëse “****” sh.p.k., te subjekti i rivlerësimit bëhet kundrejt çmimit 41,000 euro.

Bazuar në këtë kontratë është rënë dakord që shuma e blerjes së kësaj pasurie do të kalojë nëpërmjet bankës (BKT) në numrin e llogarisë së noterit dhe më pas te pala shitëse.

Për këtë pasuri, pas likuidimit të shumës, është lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie (pasuria nr. ***) në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij, në datën 3.4.2015.

Veprimet e transaksioneve bankare lidhur me likuidimin e shumës për blerjen e kësaj pasurie janë raportuar edhe nga DPPPP-ja me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2017, përkatësisht, në datën 2.4.2015 subjekti ka kryer transaksione me vlerë 2,400,000 lekë dhe 1,800,000 lekë.

Gjithashtu, në deklaratën periodike për vitin 2015, për këtë pasuri subjekti ka deklaruar:

*Blerje apartamenti në ***, Tiranë me sip. 75.7 m² dhe 10 m² sipërfaqe e përbashkët, në datën 1.4.2015, shoqërisë “****” sh.p.k., në emër të subjektit dhe bashkëshortes (e regjistruar në datën 3.4.2015). Pjesa është bërë në datën 2.4.2015. Vlera e pasurisë është 41,000 euro.*

Burimi i krijimit:

- kursimet në vite në depozita kursimi dhe në *cash*;
- shuma 1,395,000 lekë është tërhequr nga “Intesa Sanpaolo Bank”, formuar nga depozita në emër të bashkëshortes, plus kthimi i borxhit nga znj. A.P., në shumën 480,000 lekë (tërhequr në datën 2.4.2015 nga “Intesa Sanpaolo Bank”);
- depozita në fondin e investimeve të bashkëshortes, në shumën 342,800 lekë;
- llogaria rrjedhëse e bashkëshortes në “Tirana Bank”, në shumën 11,000 euro.

Për sa më sipër, nga Komisioni u konstatua se këtë pasuri dhe burimin e krijimit subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktë edhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2015, të dorëzuar në ILDKPKI.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit të rivlerësimit për pasurinë apartament me sip. 75.7 m².

Rezultoi se shlyerja e plotë e kësaj pasurie është bërë me lidhjen e kontratës në vitin 2015 nëpërmjet llogarisë përkatëse të noterit. Komisioni, bazuar në analizën financiare, ka vlerësuar mundësinë financiare të subjektit për shlyerjen e detyrimeve për blerjen e kësaj pasurie nga burime të ligjshme të krijuara ndër vite. Çmimi i blerjes prej 540 euro/m² nuk është konstatuar nga Komisioni si çmim, i cili është nën koston e ndërtimit për zonën në fjalë.

❖ **Autoveturë**, tip “Renault Schenic”, viti i prodhimit 2000, në emër të A., dhe A. D.; blerë me kontratë datë 3.2.2010. Vlera totale është 550.000 lekë.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- kursimet *cash* të vitit 2009.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet nga DPSHTRR-ja.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Për këtë pasuri rezultoi se në datën 3.2.2010, me kontratën nr. ***, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë automjetin tip “Renault”, me targa TR ***, nga shitësi E. D. Vlera e blerjes së këtij automjeti rezulton në shumën 550,000 lekë. Ky automjet rezulton i shitur më pas nga bashkëshortja e subjektit në datën 25.1.2017 (5 ditë pas plotësimit të deklaratës “Vetting”), në vlerën 200,000 lekë.

Blerjen e kësaj pasurie subjekti e ka deklaruar dhe në deklaratën periodike për vitin 2010, të dorëzuar në ILDKPKI, në vlerën prej 550,000 lekësh, me burim krijimi: kursimet për vitin 2009. Në deklaratën periodike për vitin 2009, subjekti ka deklaruar kursime *cash* në vlerën 800,000 lekë, ndërsa për vitin 2010 ka deklaruar kursime *cash* në vlerën 850,000 lekë.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie. Bazuar në deklaratat e subjektit dhe në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, është konstatuar mundësia e subjektit për blerjen e kësaj pasurie, si dhe burimi i ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie nga subjekti dhe bashkëshortja.

❖ **Autoveturë**, tip “Renault Twingo”, viti prodhimi 2001, në emër të bashkëshortes, blerë në datën 6.2.2013, sipas kontratës së shitblerjes. Vlera e automjetit është deklaruar 2,600 euro.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- kursimet në llogarinë rrjedhëse në “Tirana Bank” në emër të bashkëshortes, llogari në të cilën kryhej pagesa e qirasë së apartamentit pranë ***.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e DPSHTRR-së.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Pas hetimit të kryer nga Komisioni rezultoi se në datën 6.2.2013, me kontratën nr. ***, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Renault Twingo”, me targa BV ***, nga shitësi A.N. Vlera e blerjes së këtij automjeti rezulton në shumën 2,600 euro. Për këtë mjet është lëshuar leja e qarkullimit në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. A.D., dhe mjeti është pajisur me targa AA ***.

Blerjen e kësaj pasurie subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 të dorëzuar në ILDKPKI: “*Blerje automjeti e bashkëshortes, ‘Renault Twingo’ në shumën 2,600 euro, siguruar nga llogaria bankare në ‘Tirana Bank’*”.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit. Në analizën financiare është konstatuar edhe mundësia e subjektit, si dhe burimi i ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie.

❖ **Gjendje cash** në shumën 150,000 lekë, në janar të vitit 2017.

Konstatimi i ILDKPKI-së: ILDKPKI-ja nuk është shprehur lidhur me këtë likuiditet të subjektit.

Rezultoi se në deklaratën periodike për vitin 2016 subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*, ndërsa në vitin 2015 subjekti ka deklaruar kursime *cash* në vlerën 300,000 lekë.

Në përfundim konstatohet se:

Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë deklaram të subjektit. Në analizën financiare është konstatuar edhe mundësia e subjektit, si dhe burimi i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

❖ **Depozitë bankare** në emër të vajzës së subjektit A.D., në shumën 127,817 lekë, në “ProCredit Bank”; gjendja në tetor të vitit 2016.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar ka ndodhur për shkak të paraqitjes në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 20.10.2016, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 20.1.2017.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Bazuar në shkresën e “ProCredit Bank” të datës 20.10.2016, gjendja e llogarisë bankare të emër të vajzës së subjektit A.D., është 127,817.53 lekë. Këtë llogari bankare subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore të dorëzuar në ILDKPKI. Komisioni verifikoi edhe veprimet e kryera për këtë llogari bankare që nga momenti i krijimit, deri në plotësimin e deklaratës “Vetting” nga subjekti i rivlerësimit.

Në përfundim konstatohet se:

Rezultoi se subjekti e ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” këtë likuiditet. Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie nga burime të ligjshme.

❖ **Llogari rrjedhëse** në emër të bashkëshortes së subjektit në shumën 101,827 lekë, në “Raiffeisen Bank”.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- të ardhurat e krijuara nga pagesat e përfituara nga dhënia me qira e apartamentit në Yzberisht, Tiranë.

Deklarimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Bazuar në konfirmimin e “Raiffeisen Bank” të datës 23.12.2016, rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka gjendje të llogarisë bankare në shumën prej 101,827.30 lekësh.

Në përfundim konstatohet se:

Rezultoi se subjekti e ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” këtë likuiditet. Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie nga burime të ligjshme.

- ❖ **Llogari rrjedhëse** në emër Altin Dumani, në shumën 224,535 lekë, datë 23.12.2016, në “BKT”.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “BKT”-ja.

Pas verifikimit nga Komisioni rezultoi se “BKT”-ja më shkresën e datës 23.12.2016 ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka llogari bankare dhe gjendja e tij deri në këtë datë është 224,535.58 lekë.

Në përfundim konstatohet se:

Rezultoi se subjekti ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” këtë likuiditet. Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie nga burime të ligjshme.

- ❖ **Llogari rrjedhëse** në emër të bashkëshortes së subjektit në shumën 820 euro, datë 19.1.2017, në “Intesa Sanpaolo Bank”.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

“Intesa Sanpaolo Bank” me anë të *statement*-it, datë 19.1.2017, konfirmoi se bashkëshortja e subjektit disponon llogari pranë kësaj banke në vlerën 820.97 euro.

Në përfundim konstatohet se:

Rezultoi se subjekti e ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” këtë likuiditet. Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie nga burime të ligjshme.

- ❖ **Llogari rrjedhëse** në emër të bashkëshortes së subjektit në shumën 61.557 lekë, datë 19.1.2017, në “Credins Bank”.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- llogari bankare e krijuar nga të ardhurat nga paga.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

“Credins Bank” konfirmoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në datën 19.1.2017, disponon llogari bankare pranë kësaj banke në vlerën 61,557 lekë.

Në përfundim konstatohet se:

Rezultoi se subjekti ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” këtë likuiditet. Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie nga burime të ligjshme.

❖ **Llogari rrjedhëse** në emër të subjektit në shumën 205 lekë, në datën 20.1.2017, në “Credins Bank”.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

- llogari bankare e krijuar nga të ardhurat nga paga.

Konstatimi i ILDKPKI-së: Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

Me shkresën nr. *** prot., datë 25.7.2017, “Credins Bank”, ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit ka llogari page, dhe gjendja në datën 20.1.2017 është në vlerën 205 lekë.

Në përfundim konstatohet se:

Rezultoi se subjekti e ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” këtë likuiditet. Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie nga burime të ligjshme.

❖ **Të ardhurat** e krijuara nga dhënia e pasurive me qira.

Subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiratë:

- Të ardhurat nga qiraja e apartamentit me vendndodhje pranë ***”. Kontrata e qirasë është lidhur me shoqërinë kroate “****” në datën 25.11.2009, dhe ka vazhduar deri në janar të vitit 2016. Pagesa është bërë në llogarinë rrjedhëse në emër të znj. A.D., në “Tirana Bank”.

Për këtë është pyetur subjekti, i cili ka sqaruar se:

“Që prej dhënies me qira të këtij apartamenti, po jetojmë në shtëpinë private të prindërve të bashkëshortes, J., dhe A.P., (pa qira). Ky fakt është deklaruar në deklaratat e mëparshme. Të ardhurat neto nga kjo kontratë qiraje 36,630 euro. Totali i detyrimeve tatimore të paguara është 622,061 lekë. Bashkëlidhur kontrata e datës 25.11.2009, zgjatjet e kontratës si dhe ndërprerja e kontratës. Gjithashtu, bashkëlidhur do të gjeni edhe vërtetimin mbi derdhjen e tatimit në burim të datës 17.10.2016, si dhe printimin e llogarisë rrjedhëse të ‘Tirana Bank’ ku është bërë pagesa.”

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” apartamentin që ka në përdorim, dhe as burimin e krijimit. Por, këtë pasuri subjekti e ka deklaruar si adresë banimi në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”.

Lidhur me këtë fakt, subjekti është pyetur nga Komisioni, i cili ka kthyer përgjigje sipas pyetësorit nr. 2⁷. Bazuar në përgjigjen e subjektit dhe provat shkresore, rezultoi se pasuria apartament që subjekti ka pasur në përdorim është e regjistruar dhe në pronësi në emër të

⁷ Shikoni përgjigjen e subjektit të dërguar në Komisioni në datën 19.6.2019.

prindërve të bashkëshortes së subjektit. Kjo pasuri është ndërtuar në vitin 2001 dhe aplikimi për legalizim është bërë në vitin 2005, fakt i cili provon ndërtimin e plotë të kësaj pasurie të paluajtshme. Subjekti i rivlerësimit, bazuar dhe në deklaratat vjetore periodike të dorëzuara në ILDKPKI, ka filluar ta përdorë këtë pasuri të paluajtshme që prej vitit 2009. Gjithashtu, Komisioni konstatoi se kjo pasuri është ndërtuar me të ardhurat e ligjshme të prindërve të bashkëshortes, nga kontributi i pastorit G. B, si dhe nga fondet e kishave në Angli⁸.

- Të ardhura nga qiraja e apartamentit me vendndodhje pranë ***” me shtetasin italian U. N., dhe shtetasen shqiptare S.Z., (pas zgjidhjes së kontratës me shoqërinë “***”).
- Të ardhura nga kontrata e qirasë, datë 22.8.2016, lidhur me shtetasin amerikan M. W.H., për një periudhë 2-vjeçare, me çmim 450 euro/muaj (apartamenti tek ***, pas zgjidhjes së kontratës me shtetasin italian U. N.).
- Të ardhura nga kontrata e qirasë, lidhur në datën 13.12.2013 me shoqërinë “***” sh.p.k., për një periudhë 5-vjeçare, me çmimin 20.000 lekë/muaj, me objekt: dhënien me qira të ambientit me sip. 28 m², dhe vendndodhje pranë ***, Tiranë.
- Të ardhura nga dhënia me qira e ambientit me sip. 28 m², pranë ***për periudhën janar – dhjetor 2012, me çmim 20,000 lekë/muaj, dhënë shtetases B.K., pa kontratë dhe pagesa është bërë *cash*.
- Të ardhura nga kontrata e qirasë e lidhur në datën 6.7.2015 me organizatën “***”, përfaqësuar nga znj. O. R., dhe zgjatjen e kontratës (me qëllim strehimin e dy vullnetarëve irlandezë). Objekt i kësaj kontrate qiraje ishte apartamenti në Yzberisht.
- Të ardhura nga kontrata e qirasë, lidhur para noteres në datën 24.10.2016, me shtetasen K.I. Objekt i kësaj kontrate qiraje është apartamenti në Yzberisht (i blerë në vitin 2015), me çmim 25,000 lekë/muaj.

Lidhur me pagesën e detyrimeve që rrjedhin nga qiraja, subjekti ka paraqitur dokumentacion provues për një pjesë të detyrimeve të shlyera, ku figuron pagimi i detyrimeve tatimore nga vetë ai, ndërsa për pjesën tjetër ka shpjeguar se detyrimi për pagimin e tatimeve nuk është përgjegjësi e subjektit, por e subjekteve qiramarrëse.

Për të ardhurat e qirave i është dërguar shkresë Drejtorisë së Tatimeve, ku në përgjigjen e saj ka theksuar:

- Lidhur me kontratën e qirasë me shoqërinë “***”, kjo shoqëri ka të regjistruar pagesat e “Tatimit në burim”, pas datës 1.12.2014, për të cilat Drejtoria e Tatimeve nuk e konfirmon nëse janë pagesa të kryera për këtë kontratë.
- Lidhur me kontratën e qirasë me organizatën “***”, është përcaktuar se tatimi në burim do të paguhet nga qiramarrësi, por që nuk rezultojnë të dhëna në sistemin tatimor për periudhën pas datës 1.9.2016.
- Lidhur me kontratën e qirasë me shoqërinë “***”, pagesat janë deklaruar nga dhjetori 2014 e në vazhdim.

Lidhur me këto detyrime, nëse i referohemi shkresës nr. *** prot., datë 14.5.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rezultoi se detyrimi për pagimin e tatimit në burim është i subjektit qiramarrës.

⁸ Shikoni faqet 12-15 në përgjigjet e subjektit të datës 19.6.2019 dhe provat e administruara nga Komisioni.

Komisioni, lidhur me pagimin e detyrimeve, gjatë rezultateve të hetimit i kërkoi përsëri shpjegime subjektit të rivlerësimit. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti dokumentacion provues lidhur me pagimin e detyrimeve në buxhetin e shtetit për të ardhurat e përfituar nga subjektet qiramarrëse⁹.

Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me të ardhurat e krijuara nga subjektit i rivlerësimit nga dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, në pronësi dhe në posedim të tij.

❖ Lidhur me detyrimet e subjektit

Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar edhe detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë si më poshtë:

1. Kontratë kredie, në shumën 5,000,000 lekë, datë 1.11.2006 , në “Raiffeisen Bank”, marrë për blerjen e apartamentit (sipas kontratës së porosisë të datës 18.8.2006), me afat 25 vjet (300 muaj). Norma e interesit: 12 %, nga e cila, 3 % paguhet nga subjekti dhe 9 % paguhet nga Ministria e Financës për të gjithë kohëzgjatjen e kredisë.
 - Si garanci hipotekare është vendosur apartamenti në pronësi të shtetasve A., (djali i xhaxhait të bashkëshortes së subjektit) dhe A. P. Gjithashtu, edhe apartamenti në emër të Gj. L., (baxhanaku i subjektit), J. L., etj.
 - Sipas kontratës së datës 29.4.2015, garanci hipotekare është vendosur apartamenti në pronësi të shtetasve Altin dhe A. D., i cili është blerë në datën 1.4.2015 dhe është lënë i lirë apartamenti i Gj. L., J.L., etj.
 - Shuma e mbetur pa shlyer deri në datën 27.12.2016, është 3,418,419 lekë, ndërsa interesat janë 3,418 lekë.
2. Hua, dhënë motrës së bashkëshortes të subjektit, znj. A. P., në shumën 1,000,000 lekë, e shlyer plotësisht nga kjo e fundit.
 - Kësti i parë është paguar në datën 29.12.2010, në shumën 500,000 lekë, dhe kësti i fundit është paguar në datën 19.3.2015, në shumën 480,000 lekë. Këto këste janë paguar me transferta bankare në “Raiffeisen Bank”. Shuma prej 20,000 lekësh është dhënë *cash*.

Lidhur me hetimin e kryer mbi këto detyrime të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk konstatoi parregullsi dhe se këto deklarime të bëra nga subjekti rezultuan të sakta.

ANALIZA E PËRMBLEDHUR FINANCIARE

	I	II	III	IV = (II-III)	V	VI = I - IV - V
VITI	Të ardhura	Pasuria	Detyrime	Pasuria <i>neto</i>	Shpenzime	Rezultati
2003	1,199,352	831,846	0	831,846	187,928	179,578
2004	1,587,140	-1,082,521	0	-1,082,521	1,041,892	1,627,769
2005	2,168,312	877,102	0	877,102	715,719	575,491
2006	2,460,760	8,795,811	7,109,604	1,686,208	634,791	139,761
2007	2,181,931	1,085,104	-146,633	1,231,737	893,557	56,637

⁹ Shikoni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit të administruar në dosjen e Komisionit.

2008	2,571,023	-1,804,434	-2,146,633	342,199	1,256,732	972,092
2009	2,785,719	1,575,061	-49,273	1,624,334	547,754	613,631
2010	2,912,588	1,843,067	353,367	1,489,700	597,754	825,134
2011	2,985,549	61,386	-1,253,746	1,315,132	765,044	905,373
2012	3,039,740	1,257,726	-146,943	1,404,669	1,150,567	484,503
2013	2,783,999	1,103,887	-164,707	1,268,594	805,998	709,407
2014	3,281,440	671,793	-169,185	840,978	1,475,080	965,382
2015	3,325,060	1,329,131	324,975	1,004,156	1,943,147	377,757
2016	2,745,516	302,560	-179,622	482,183	1,694,174	569,159
TOTAL	36,028,130	16,847,519	3,531,202	13,316,317	13,710,137	

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Analiza financiare është bazuar në deklaratën “Vetting”, deklaratat periodike vjetore 2003 – 2016, të dorëzuar në ILDKPKI, si dhe në përgjigjet e pyetësorit të dërguar nga subjekti.

Në deklaratat periodike vjetore subjekti ka deklaruar gjendje *cash* dhe kursime për vitet përkatëse. Bazuar në këto deklarime të subjektit nga Komisioni është përgatitur edhe analiza financiare.

Konkretisht, në vitin 2003 ka deklaruar gjendjen *cash* në vlerën 500,000 lekë. Në vitin 2004 nuk ka deklaruar shtim apo pakësim të gjendjes *cash*; në vitin 2005 ka deklaruar kursime nga paga në vlerën 1,1 milion lekë; në vitin 2006 ka deklaruar kursime nga paga në vlerën 1,2 milion lekë – vit në të cilin subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” pagesën e kryer në vlerën 9,000 euro për blerjen e apartamentit, e cila është përballuar nga kursimet e krijuara. Pra, në vitin 2006 analiza financiare është bërë bazuar në kursimet e subjektit të akumuluar nga vitet 2003, duke zbritur vlerën prej 9,000 euro. Në vitin 2006 gjendja e mbetur nga kursimet *cash* rezultoi në vlerën 1,686,673 lekë; në vitin 2007 subjekti ka deklaruar kursime *cash* në vlerën 500,000 lekë; në vitin 2008 subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* për këtë vit; në vitin 2009 subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në vite për shkak të blerjes së pasurisë me sip. 28 m². Subjekti ka deklaruar kursime për vitin 2009 *cash* në vlerën 800,000 lekë. Analiza financiare për vitin 2009 është hartuar duke u bazuar në pakësimin e gjendjes së mëparshme të kursimeve *cash* në vlerën 2,186,673 lekë dhe shtimin e gjendjes *cash* në vlerën 800,000 lekë. Në vitin 2010 subjekti ka deklaruar shtim të gjendjes *cash* në vlerën 850,000 lekë si dhe pakësim të gjendjes *cash* të vitit 2009 për blerjen e automjetit në vlerën 550,000 lekë, në janar të vitit 2010. Në fund të vitit 2010 rezultoi se subjekti ka pasur gjendje kursime *cash* në vlerën 1,1 milion lekë.

Kjo llogaritje për gjendjen e kursimeve *cash* është bërë dhe në vazhdim për të gjithë analizën financiare, deri në vitin 2016. Por, mbetet për t’u theksuar se në disa deklarata periodike vjetore subjekti nuk ka deklaruar zvogëlimin e gjendjes së kursimeve *cash* për vitet që ka blerë pasuritë dhe ka përdorur gjendjen e kursimeve *cash* për blerjen e tyre.

Në këtë analizë financiare të hartuar nga Komisioni nuk është përfshirë deklarimi i subjektit lidhur me të ardhurat dhe kursimet *cash* në vlerën prej 10,500 USD. Në deklaratat periodike dhe në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar se e ka pasur këtë gjendje *cash* në vlerën

prej 10,500 USD. Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se në vitin 2003 ka pasur dy llogari bankare në emër të bashkëshortes, njëra në vlerën 3,662 USD dhe tjetra në vlerën 5,144 euro. Këto llogari bankare janë tërhequr nga subjekti në vitin 2004, i cili ka pretenduar se këto vlera monetare të tërhequra janë mbajtur *cash* prej tij deri në vitin 2009.

Për këtë subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për të provuar deklaratimet e tij dhe të kundërtën e gjetjeve të konstatuar nga Komisioni.

Nga administrimi i shkresave dhe provave të tjera që ndodhen në dosjen e Komisionit lidhur me hetimin e kryer, nuk rezultuan indice lidhur me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të tjera për kriterin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së, nr. ***, datë 18.7.2019, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: *“Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Altin Dumani”*.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin profesional të subjektit Altin Dumani është përgatitur nga KLP-ja, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) formularit të vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) pesë dosjet/praktikat penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) të dhënat nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Raporti është kontrolluar dhe vlerësuar, dhe relatori ka paraqitur përpara trupit gjykues të Komisionit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Altin Dumani, në përputhje me nenin 44, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

❖ 5 dosjet e përzgjedhura me short

Dosja nr. 1

- Dokumenti ligjor – Konkluzione për vendimin penal nr. ***, datë 7.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dosja nr. 2

- Dokumenti ligjor – Konkluzione për vendimin penal nr. ***, datë 12.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Dosja nr. 3

- Dokumenti ligjor – Rekurs kundër vendimit penal nr. ***, datë 20.5.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Dosja nr. 4

- Dokumenti ligjor – Konkluzione për vendimin nr. *** akti, datë 13.9.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dosja nr. 5

- Dokumenti ligjor – Konkluzione për vendimin nr. ***, datë 27.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

❖ ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit:

- formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti;
- pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short;
- të dhënave nga prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe të Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga analiza e dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Altin Dumani, për sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi mjaft të mira në drejtim të zbatimit të ligjit.

Prokurori Altin Dumani bën një analizë të qartë të dispozitave ligjore duke u ndalur në zbatimin e saj, referuar të dhënave të rastit objekt gjykimi. Shfaq njohuri shumë të mira dhe të plota në drejtim të normave të Kodit të Procedurës Penale dhe njohuri shumë të mira në drejtim të metodikave të hetimit.

Në përgatitjen e akteve, subjekti i rivlerësimit respekton dispozitat procedurale penale, por edhe të Urdhrit nr. 174, datë 5.9.2003, *“Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”* të Prokurorit të Përgjithshëm.

Kështu, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar se ka përballuar një ngarkesë pune shumë voluminoze dhe komplekse me cilësi dhe shpejtësi. Ka treguar profesionalizëm në interpretimin e ligjit procedural dhe material penal, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte procedurale tepër cilësore.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit mbi kualifikimet në fushën e të drejtës penale, konstatohet se ka fituar titullin “Master i nivelit të dytë në Shkenca Penale”; ka marrë pjesë në cilësinë e relatorit/ekspertit/prezantuesit në disa tema në fushën penale, gjatë aktiviteteve të zhvilluara në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme, gjë që tregon për aftësi shumë të mira në njohjen e ligjit.

Gjithashtu, është për t’u nënvizuar edhe vlerësimi i datës 10.12.2009, që OPDAT, Ambasada Amerikane, Tiranë, i ka bërë punës që subjekti i rivlerësimit, z. Altin Dumani, ka kryer si drejtues i Njësisë së Përbashkët Hetimore pranë Prokurorisë së Tiranës. Më konkretisht, në këtë letër shkruhet: *“Nën drejtimin e z. Altin Dumani gjatë dy viteve të shkuara, Njësia e Përbashkët*

Hetimore e Tiranës, është kthyer në një histori të njohur suksesi, duke ndërtuar një reputacion të shkëlqyer brenda Shqipërisë, dhe duke fituar njohje nga disa raporte ndërkombëtare. Gjatë vitit 2008, viti i parë i plotë kalendarik i veprimtarisë së Njesisë së Përbashkët Hetimore të Tiranës, çështjet e korrupsionit u rritën në 45 % dhe çështjet e pastrimit të parave u rritën në 380 %. Këto janë rezultatet e dallueshme dhe z. Altin Dumani duhet të përgëzohet për rolin e tij të rëndësishëm në suksesin e Njesisë së Përbashkët Hetimore të Tiranës.”

❖ TË DHËNAT NGA BURIMET ARKIVORE TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, si dhe burimet në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk rezulton që subjekti Altin Dumani:

- Të ketë masa disiplinore lidhur me punën e kryer.
- Të ketë të dhëna apo indice të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.
- Të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).
- Të ketë pasur ndaj tij procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- Subjekti i rivlerësimit, z. Altin Dumani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ka vlerësimin “shumë mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm.

Komisioni, bazuar në të dhënat e Prokurorisë së Përgjithshme, konstatoi vetëm një çështje të ndjekur nga Prokuroria e Përgjithshme për subjektin e rivlerësimit dhe konkretisht, për çështjen e shtetasit Z. K.

Në datën 4.2.2015, në Prokurorinë e Përgjithshme është paraqitur ankesa e shtetasit Z. K., me objekt: ankesë për kërkesën, heqje dorë nga ankimimi kundër vendimit penal të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, të deklaruar verbalisht dhe me shkrim në seancën gjyqësore të datës 16.1.2015, të prokurorit Altin Dumani.

Në ankesën e tij, shtetasi Z. K., pretendon se prokurori Altin Dumani, subjekt i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit në Gjykatën e Apelit Tiranë, ka hequr dorë në mënyrë të parregullt nga apeli i ushtruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, lidhur me çështjen penale në ngarkim të shtetasit M.G., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “ndërtim të paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal.

Ankesa e shtetasit Z.K., është marrë në shqyrtim nga Drejtoria Gjyqësore dhe Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve, në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga kjo drejtori, me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2015, i është kthyer përgjigje në adresën e tij shtetasit Z. K.

Përgjigja është marrë nga shtetasi Z. K., i cili, duke mos qenë dakord, i ka nisur një shkresë ankese sërish Prokurorisë së Përgjithshme, dhe për dijeni, Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe ministrit të Drejtësisë. Kjo ankesë është protokolluar me nr. ***, në datën 23.3.2015, në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe e njëjta ankesë është depozituar në datën 24.3.2015, në

Ministrinë e Drejtësisë. Kjo e fundit e ka dërguar këtë ankesë për kompetencë në Prokurorinë e Përgjithshme, ku është protokolluar në datën 17.4.2015.

Në ankesën e radhës, shtetasi Z. K., nuk është dakord me përgjigjen e kthyer me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2015, nga Drejtoria Gjyqësore, duke pretenduar se ankesa e tij i drejtohej drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Tiranë, nga i cili priste përgjigje. Gjithashtu, ai ka pretenduar se në ankesën e tij të parë kërkonte që të kryhej një ekspertizë dokumentare mbi praktikën e veprimit të prokurorit Altin Dumani, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve të drejta mbi saktësinë e fakteve që janë përdorur nga Prokuroria e Rrethit Krujë në kërkesat për gjykim të çështjes, për të cilën nga prokurori i apelit, z. Altin Dumani, është hequr dorë nga ankimi i bërë nga prokurori i Prokurorisë Krujë.

Edhe kjo ankesë e dytë është shqyrtuar nga Drejtoria Gjyqësore dhe Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Prokuroria e Përgjithshme, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2015, i ka kthyer përgjigje ankuesit Z. K., duke i sqaruar:

“...Prokuroria e Përgjithshme ka arritur në përfundimin se heqja dorë nga apeli i sipërpërmendur ishte një qëndrim i drejtë i Prokurorisë së Apelit Tiranë, pasi konstatoi se në veprimet e të pandehurit M. G., mungojnë elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal, bazuar në këtë arsyetim ...

*Për të gjitha këto arsye heqja dorë nga apeli kundër vendimit nr. ***, datë 6.2.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është vlerësuar nga ana jonë si e bazuar dhe në përputhje me ligjin.”*

Në përfundim, pas përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional për pesë çështjet e shortuara për subjektin e rivlerësimit dhe çështjet e ndjekura nga prokuroritë e rretheve dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Trupi gjykues nuk gjeti asnjë indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e magjistratit.

D. DENONCIMET

Në Komision janë paraqitur katër denoncime për subjektin e rivlerësimit, z. Altin Dumani, si më poshtë:

1. Kërkesë e z. A.A., drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, protokolluar me nr. ***, datë 3.1.2019, në Komision. Nga kjo kërkesë nuk rezultoi indice për subjektin e rivlerësimit.
2. Denoncim i z. J.D., protokolluar me nr. ***, datë 8.1.2018, në Komision. Shtetasi J. D., denoncon subjektin e rivlerësimit, si dhe dy gjyqtarë për zvarritje të procesit gjyqësor.

Për këtë çështje është bërë shkresë nga Komisioni drejtuar Prokurorisë së Apelit Tiranë, ku është kërkuar dosja përkatëse për të verifikuar veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit. Me shkresën nr. ***, datë 3.6.2019, Prokuroria e Apelit Tiranë¹⁰ ka kthyer përgjigje duke përcjellë edhe dosjen përkatëse, dosje e cila është shqyrtuar dhe vlerësuar nga Komisioni.

¹⁰ Shikoni përgjigjen e prokurorisë dhe praktikën përkatëse në dosjen e administruar nga Komisioni.

3. Denoncim i shtetasve F., dhe Sh.A., protokolluar me nr. ***, datë 8.1.2018 në Komision. Nga ky denoncim nuk rezultoi indice për subjektin e rivlerësimit por për subjekte të tjera të përmendur në këtë denoncim.
4. Denoncim i shtetasit F.K., protokolluar me nr. ***, datë 24.6.2019, në Komision. Në denoncimin e paraqitur nuk rezultojnë indice për subjektin e rivlerësimit (në denoncim përmenden dy subjekte të tjerë).

Lidhur me këto denoncime, pasi u analizuan nga Komisioni, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti paraqiti shpjegimet e tij të detajuara¹¹, si dhe procedurat që ka ndjekur lidhur me çështjet e denoncuar.

➤ **Në përfundim:**

Mbështetur në raportin e vlerësimit profesional për çështjet e shortuara dhe denoncimet e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

Në vlerësimin lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Altin Dumani, nuk rezultoi të jetë gjetur ndonjë problem mjaftueshëm i rëndësishëm që do të çonte në një vlerësim aftësish profesionale më pak, ose ndryshe nga ai “i përshtatshëm”, sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Komisioni, në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të vlerësimit të figurës dhe të vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

Për vlerësimin e pasurisë

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit subjekti ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe interesave private, si dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Altin Dumani, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato në *cash*) dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si prokuror.

¹¹ Shikoni shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit të dërguar nga Komisioni.

Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Altin Dumani, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të gërmës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” .

KONKLuzioni Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, z. Altin Dumani, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gërmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, dhe nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Altin Dumani, me detyrë prokuror, aktualisht drejtues i Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 31.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI

Kryesues

Etleda ÇIFTJA

Anëtare

Roland ILIA

Relator

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore